

Si të merrni ndihmë për të paguar faturat tuaja të spitalit

Nuvance Health zotohet që t'i ndihmojë pacientët me faturat e spitalit.

Kopje të **politikës për ndihmën financiare** të Nuvance Health dhe aplikimet për ndihmën financiare mund të gjenden në Njësinë e Biznesit të Qendrës, Departamenti i Regjistrimit, Departamenti i Emergjencës ose Zyra e Marrëdhënieve me Komunitetin. Aplikimet janë të disponueshme në anglisht, spanjisht, portugalisht dhe në gjuhë të tjera që janë të zakonshme në komunitetet tona.

Nuvance Health Hospitals (Danbury, New Milford, Norwalk dhe Sharon Hospitals në CT, dhe Vassar Brothers Medical Center, Northern Dutchess Hospital dhe Putnam Hospital në NY) do të vendosin sa më shpejt të jetë e mundur nëse ju kualifikoheni për ndihmë financiare pasi të kenë marrë një aplikim të plotësuar për ndihmë. Do të merrni njoftim me shkrim lidhur me rezultatin e rastit tuaj.

Nëse aplikimi juaj refuzohet, ne do t'ju japim arsyen për refuzimin dhe do t'ju japim informacion se si të apelonit vendimin. Nëse zgjidhni të apelonit, do të punojmë së bashku për t'u siguruar që të marrim parasysh të gjitha faktet kur të marrim vendimin përfundimtar.



Ndihma financiare



544468_Plain Language Financial Asst Policy - ALB-SQ_F_1124

nuvancehealth.org/financialassistance

Kualifikimi për ndihmë me faturat tuaja mjekësore



Jeni të pasiguruar ose keni probleme me pagimin e faturave të spitalit?

Ne mund t'ju ndihmojmë. Nëse jeni duke u përballur me një vështirësi financiare për shkak të kostove të sigurimit ose kostove mjekësore tepër të mëdha, mund të ofrohet ndihmë financiare për të mbuluar disa ose të gjitha kostot e shërbimeve për pacientë të shtruar, pacientë ambulatorë dhe ato të emergjencës të ofruara nga Nuvance Health Hospitals (Danbury, New Milford, Norwalk dhe Sharon Hospitals në CT, dhe Vassar Brothers Medical Center, Northern Dutchess Hospital dhe Putnam Hospital në NY).

Ju lutemi vini re:

Nuvance Health Hospitals do të paguajmë gjithnjë trajtimin mjekësor urgjent pavarësisht nga aftësia juaj për të paguar.

Kriteret

Spitalet tona do t'ju ofrojnë ndihmë financiare në rast se **plotësohen një ose disa** prej kushteve të mëposhtme:

- Ju keni një ose më shumë balance të pashlyera ndaj Nuvance Health Hospitals ose ofruesve të tjerë.

- Ju keni aplikuar dhe nuk pranoheni si person që kualifikoheni për ndonjë mbulim mjekësor ose të kujdesit shëndetësor në Medicaid ose në programe shtetërore ngaqë nuk plotësoni kërkesat për të ardhurat ose kërkesat e tjera për kualifikimin.
- Ju nuk kualifikoheni për shërbime spitali sipas ndonjë programi tjetër të sigurimit shëndetësor ose sigurimit në rast aksidentesh (si kompensimi i punëtorëve, përgjegjësia e palëve të treta ose sigurimi i mjeteve motorike).
- Të ardhurat e familjes suaj janë në ose nën nivelin 400% të Direktivave Federale për të Ardhurat e Pakta (bazuar në Direktivat Federale për të Ardhurat e Pakta).

Nëse familja juaj është mbi nivelin 400% të Direktivave Federale për të ardhurat e pakta dhe ju përballeni me fatura mjekësore tepër të mëdha, mund të kualifikoheni përsëri për zbritje në detyrimet ndaj spitalit.

Si mund të merrni ndihmë?

Konsulentët tanë financiarë të trajnuar janë në dispozicion për t'ju ndihmuar që të përcaktoni nëse kualifikoheni për ndihmë financiare. Konsulentët tanë financiarë mund t'ju ndihmojnë që të aplikoni për ndihmë financiare nga programet qeveritare dhe që të bëni marrëveshje për pagesat. Gjithashtu ata mund të miratojnë kryerjen e rregullimeve në

bilancin tuaj në bazë të nevojave financiare dhe/ose vështirësive mjekësore. Çdo pacient që kualifikohet për ndihmë financiare nga Nuvance Health nuk do të tarifohet më shumë se shumat e faturuara përgjithësisht (AGB) për kujdesin emergjent ose të nevojshëm nga ana mjekësore.

Ju lutemi na kontaktoni

Për çdo pyetje, ose për të marrë një kopje të politikës për ndihmën financiare dhe një aplikim për ndihmë financiare me postë, email ose në kopje fizike, telefononi ose vizitoni Shërbimet Financiare për Pacientin në:

- Danbury Hospital:** (203) 739-7773
24 Hospital Avenue, Danbury, CT 06810
(Orari i vizitave, e hënë–e premte, 09:00–16:00)
- Norwalk Hospital:** (203) 899-1579
34 Maple Street, Norwalk, CT 06856
(Orari i vizitave, e hënë–e premte, 09:00–16:00)
- New Milford Hospital:** (860) 210-5427
21 Elm Street, New Milford, CT 06776
- Sharon Hospital:** (860) 364-4275
50 Hospital Hill Road, Sharon, CT 06069
(Orari i vizitave, e hënë–e premte, 08:00–16:30)
- Vassar Brothers Medical Center:** (845) 431-5693
45 Reade Place, Poughkeepsie, NY 12601
(Orari i vizitave, e hënë–e premte, 08:30–17:00)
- Putnam Hospital:** (845) 279-5711 x4789
670 Stoneleigh Avenue, Carmel, NY 10512
(Orari i vizitave, e hënë–e premte, 07:30–16:00)
- Northern Dutchess Hospital:** (845) 871-4347
6511 Springbrook Avenue, Rhinebeck, NY 12572
(Orari i vizitave, e hënë–e premte, 08:00–16:00)

